

Poezi nga letrarë të rini



A. Rakipi, M. Ahmeti, M. Buçpapaj, R. Dibra, S. Vrushe
V. Dilo, V. Allmuça, P. Zogaj, S. Demolli, F. Kulli

844-1
P28.

Poezi
nga
letrarë
të rinj

BIBLIOTIKA TË PËRQITIMIT
ME LIBRAKU NGA KËSHIFI
DOKTORATË KULTURËS
TIRANA 1971

844-6
14140

Në këtë antologji janë përbledhur pô-ezi të disa autorëve, të cilët kanë filluar të debutojnë me krijimet e tyre të para-nëpër organet e shtypit.

Përgatitur për botim nga
MUZAFER XHAXHIU,
ADRIATIK KALLULLI,
ISUF NELAJ.

ALBERT RAKIPI

MBRËMJA E PARË NË FSHATIN E RINISË

Toka gëzohet siç gëzohet nëna
kur bij e bija i ka pranë.

Ndaj kemi ardhur plot djem e vajza,
që tokën djerr ta kthejmë në arë.

Në fshatin e ri kjo është mbrëmja e parë,
Nuk di se ç'ndiej në gjoks këtë mbrëmje,
ulur tek jam te kjo tokë e tharë.

Toka me zë nëne më thotë «mirseardhe!»

Dielli është fshehur pas pishave të larta,
s'më iket te shokët, i vetëm rri.

Autori punon në Shtëpinë e Kulturës Barmash, Ersekë.

III

NEVIRI T. VITALE - L'ESPRESSO - 1973

Dhe pishat nën yje tundjin krahët,
gëzohen dhe ato sic gëzohet një njeri.

Rri e vështroj këtë natë të qetë,
që yje ka ndezur në fshatin e ri.

Sa ç'ka yje sot, nesër drita do të ketë
dhe s'do të ketë fâre qetësi.

Ka vëtem dy, tri shtëpi të vjetra sot
dhe nepër fushë fëshférin bari i tharë.
Nepër shtëpi të reja do të ketë plot
dhe grurë e zëra fëmijësh në çdo prag.

STACIONE JETE

Ndalet urbani,
dikuş hipën,
dikush zbrethet,
gjallërohet rruga...

Ndalet këtu,
të hipin punëtorët e gurores
dhe pak më tutje
të zbresë kjo vajzë,
e presin fëmijët në shkollën e fshatit.

Dikush paska harruar në autobus
një tufë luleshqerra,
dhe shoferi qesh:
Paska ardhur pranvera!

NEA E TDAUTË

Ikin ditët,
ikën një stinë, vjen tjetra
dhe xhamat e autobuzit qëndisen
me lule të bardha.

Kështu

hipin e zbresin njerëzit
më buisjen e stinës që vjen;
më të përditshimet fjalë:
Mirmëngjes!

Mirupafshim!

Pünë të mbarë!

Dhe shoferi qesh i lumtur,

kur dikush i vete pranë:

«Të lutem ndale këtu!»

Kështu

shumohen stacionet,
siç shumohetjeta.

1. KOMUNA TË DITËS SË RERË

Pranë stacioneve të përditshme
pa tabela qëdo zinxhirë së cilin është mësim i përmes
shfaqen njerëzit qëndrojnë përmes tij
bashkë me agun e ditës së re. Në këtë
arrestat, kështu që përfundon tashmë, shqetësohet

që ndryshim i lidhjeve së vjetra i kësaj komuniteti
nëntorë, qëndrojnë përmes tij, qëndrojnë përmes tij
nëntorë, qëndrojnë përmes tij, qëndrojnë përmes tij.

Qëndrojnë përmes tij, qëndrojnë përmes tij,

Dhe të gjithë njerëzit që vijnë
qëndrojnë përmes tij, qëndrojnë përmes tij, qëndrojnë përmes tij,
qëndrojnë përmes tij, qëndrojnë përmes tij, qëndrojnë përmes tij.

HARTIMI I PARË PËR QEMALIN

Gjithë qytetarët e Shqipërisë

Mbaj mend hartimin e parë për Qemalin.
Ishte pranverë, ishte maj. Mësuesja temën shkruante në dërrasë, at
dega e bajames trokiste në xham.

Hapat dhe zëri i mësueses ndiheshin në klasë
dhe trokitja e bukur e bajames në xham.
«Nxënës! — Qemali më shumë se jetën donte
lirinë,
Qemali u vra të pestën ditë, në maj.»

Dhe të gjithë u kthyem me vrull
dhe Qemalin me patllake në dorë e pamë.
O, ç'fiste vetë ajo pikturë në mur,
për ditën e pestë të muajit maj.

SHALLOVËR

Pastaj në klasë hyri Qemali vetë,
me pushkë në krahë e yll, në ballë,
e klasa u mbush plot dritë edhe yje,
e klasa u mbush plot me partizanë...

Shallovër
Të paktën që do t'i bëj
që vërtet do t'i bëj
që vërtet do t'i bëj

Shallovër
Të paktën që do t'i bëj
që vërtet do t'i bëj
që vërtet do t'i bëj

LETËR E VËLLAIT

Ti eja në fshat,
më shkruante në letër ai.

Ti eja këtë verë vëlla,
të shohësh dhe grurin e ri.

Ti eja një herë,
të flemë të dy në mullarë,
ku vjen e këndon një mëllanjë
e gruri i pjekur kërcet në arë.

Ti eja në fshat, të shohësh
mbrëmjet dhe agimet e bukura,
ku vajzat dhe djemtë bashkë
në ara punojnë të lumtur.

Ti eja vëllav këtë stinë, që vargjet t'i mbushësh me grurë, që vargjet të bien erë trëndelinë plot këngë mëllenjash në lumë.

“A’ dëgjatën e bëj vëllav qëndroj, që dëgjatën e bëj vëllav qëndroj, që dëgjatën e bëj vëllav qëndroj, që dëgjatën e bëj vëllav qëndroj,

që dëgjatën e bëj vëllav qëndroj, që dëgjatën e bëj vëllav qëndroj, që dëgjatën e bëj vëllav qëndroj, që dëgjatën e bëj vëllav qëndroj,

E KAM DASHUR...

E kam dashur një vajzë vërtet.
Shpesh përvërtë kaj mbetur dhe pa gjumë.
E kam dashur, por njo s'mëdesh, to
unë mëri s'do t'i mbaj (kunrëgj, nd...)

E takoj mëngjeseve dhe e përshëndes,
i uroj me vete që të jetë e lumtur.
C'na pengon të jemi miq të vërtetë,
shpesh më thonë sytë e saj të bukur.

Asgjë s'na pengon, unë këtë, e di
dhe ne do të jemi miq të vërtetë.
Ndodh që malli i parë më troket në gji,
kur e takoj rrugës dhe e përshëndes.

SİBBLERIMI I PISHAVE

Midis nesh
diçka u thye, krisi ngadalë,
si ç'mund të krisë të këputet një degë piske.
Po pisha mbetet e gjelbër, qaf qum ngjohur
edhe pse këputen degë! Aku do i bët qëndruesh
Dhe miqësia jonë mbeti, që vjeniq bura. Gjë
e bukur,
e përjetshme,
si blerimi i pishave.

NË FSHATIN NË BUKUR TË RINISË

Kishin çelur mollët,
plot lule të bardha mbushur.

Ne ecnim të dy në udhën e bardhë,
mbushur me lule, nga mollët këputur:

Këputashnjë degëzëtë mollët,
një degë me lule shumët,
dhe degën ta dhashë tyjet këputashnjë
atë fund pranvere të bukur.

E more degën në duar,
tek buzëqeshje me sytë e bukur,
pastaj më pe një çast e menduar
lulet e mollës duke shkundur.

A KURBE LIPSETI

Pranë grurit të gjelbër atë pranverë
çeli lule e dashurisë,
dhe jetën lidhëm ne të dytis e artë.
në fshatin e bukur të rinisë.

Pranë grurit të gjelbër atë pranverë
çeli lule e dashurisë,
dhe jetën lidhëm ne të dytis e artë.
në fshatin e bukur të rinisë.

Pranë grurit të gjelbër atë pranverë
çeli lule e dashurisë,
dhe jetën lidhëm ne të dytis e artë.
në fshatin e bukur të rinisë.

DASMA E PARE

Ishte dasma e parë
në fshatin e rinisë.
E zakonshme sì, të gjitha daşmat,
veç mungonin fëmijët.

Erdhi një plak në dasmë
(i vetmi që kishte mbetur në fshat),
u gëzuan të gjithë të rinjtë,
në krye të tavolinës e vunë atë plak.
«Gëzuar, — uroi ai, — të na trashëgohen,
fëmijë të na bëjnë një mëhallë!»
dhe të gjithë i ngriten gotat.

Ishte dasma e parë...
mungonin fëmijët e qeshur
dhe nusja në vend të fustanit të bardhë,
një fustan në ngjyrën e grurit kishte veshur,

MËNGJES NË MINIERË

Qyteza i ka çelur dritaret të gjitha
e nga galeritë
hyjnë e dalin minatorët
me një copë diell në ballë.

I gëzohet mëngjesit që vjen
grunaja e gjelbër mbi galeri
e kallzat e pjekura,
me pika vese si me lot gëzimi,
ndihen të lumtura.

Mbi kullën e pusit ngjiten montatorët,
ca copëra mjegullash të hirta rrëzojnë.
Vjen mëngjesi
dita e re agon...

SHOKËT E MI

Kam pak ditë që punoj këtu,
që zbres galerive me këta njerëz të thjeshtë, të mirëpërsom

Kam pak ditë që punoj që shok:
dhe më flasin të gjithë s'i shok: e njohim,
O, ç'kenka kaq e ngrënhet fjalë e tyre,
këtu në zemër të malit! ja, ja, ja!

Ende s'i njoh të gjithë
dhe duart e tyre më ndrojtje i shtrëngoj,
duarit e tyre më kallol!
më thonë shumë,
duart e tyre, që përkëdhelin fëmijët mbrëmjeve.

WAKTU

Kam pak ditambah iktut apa arantidell
kétu mes tyre. ~~nae~~ emi emi. ~~Na~~ ~~Na~~
Më duan dhei dua shoket evmi
joffi. ~~B~~ukti s ña ña ña ña ña ña ña
tem ña emi s ~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~
~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~
~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~ ~~shoket~~

NJË ÇAST

Kthehesha nga turni i dytë
një natë vere me yje.
Pas shokëve u ndala një çast,
u ndala në rrugë e s'më ikej.
Ç'më ngjau qyteza ime në mal
si një shtëpi e madhe, e vetme,
mbushur me drita si yje...

ABAZ KERAJ

WANJE TUFÉ MANUSHAQEVVIV

Një tufë manushaqe kryepërpjeta
këputa sot andej nga fusha,
si nga poemat e Naimit
e mora dhe në gjë e futa....

Nga petalet e tyre zhurmë traktorësh frëzoj era, nga kjo tufë manushaqe Atdheun n'gji e ndjeva...

The following table gives the results of the experiments made at the Bureau of Fisheries, New York, during the summer of 1887.

NAFTETARËT NISEN PËR NË PUNË

Nga hapat e tyre zgjohet qyteti, dritaret dhe zemrat mbajmë, të hapura, me këto bori që dëgjohen në periferi hyjnë përshëndetjet e tyre të dashura.

Mes tyre lëviz dorën një fëmi, që shkon në kopsht mbi krahët e nënës, tek udha e naftëtarëve është lidhur, dhe ai, në ato udhë po ia rrjit hapësirat e ndrrës...

Tutje në fusha e kodra duken
puset e naftës nëpër shi e erë,
ato do të ngjiten në hapësirat e guximit,
udhë të reja drejt naftës do të gjejnë...

THÉLÉZA

Çukiti stërrallin dhe nisi këngën,
stërralli hodhi çika përpjetë,
natyra m'u duk edhe më e bukur
në Kurveleshin me kryet përpjetë.

Pastaj nisi të fluturojë
me një degë trëndeline në sqeq,
me krahë fryshtimin më përkundi,
që nëna ma mësoi në djep...

evëndimiq i jasluT
brev sñ stanđmë ët'a
sqeq pëllib rëmi o
ndonjë qëllit jasurësill

Bilbil Matohiti
kurre s'tu pre udha,
dhe shkëmbinjt e rrëptë
t'u bënë tribuna.

Ilidhjet e shtegut
dhe fushat e qytetit
e kulturore e qytetit
e fësive e qytetit

Rezervuar i përgjithshëm
dhe vlerësim i përgjithshëm
e kulturore e qytetit
e fësive e qytetit

GËZIMI NË SHTËPINË E RE

Shkela butë mbi qilimin e shtruar,
Sikur shkela mbi një lëndinë,
Fëmija i gëzuar m'u hodh në duar:
Sa e mirë, mor babi, sa e mirë!

Dhe nënës i qeshën rrudhat e ballit
Një çast duart në gjunjë i mbështeti,
E madhe iu duk shtëpia,
Qindra herë më i madh Pushteti.

FRANO KULLI

NË KUFI

Këtu heshtjen e çajnë shpesh krismat,
sa herë që shkelësit, vare pa emër kërkojnë.
Zogjtë kur prekin kapotat e ushtarëve
ndalin këngën sikur vigjilojnë.

Grunjérat a frutat edhe këtu rriten
e lule në gji të malit mbijnë,
që ëndrrat t'i ruajmë në gjumin e fëmijëve
kemi mbjellë këtu pagjumësinë.

Autori punon në Vaun e Dejës në rrethin e Shkodrës.

N E K O M A N

Gjithçka këtu i takon së tashmes,
erë e athët, e gëlqeres
në muret e ngrehinave mbuluar me eternit,
netët e çelura me flakë saldatrësht
dhe agu ngjyrë vjollce i mëngjesit,
me shushurimën e holluar të Drinit,
urraaa-të e shtruara të punëtorëve prej të dy
brigjeve,
që rrëshqasin mbi ferrobetonin e urës.
E tashme është, gjithçka,
siç është e shkuar qetësia.

Turma shtegtarësh të brigjeve
ndalin në ritmikën e stacionit të vogël
e në pragmbërmjet e zhurmshme të klubit —
xhamdërsirë...

Reportazhi i parë sapo është botuar,
kineastët akoma s'kanë arrirë.

* * * (1) *

Ti s'je më gjimnazistja lozonjare,
më ëndrrat lulemolle e erëftua,
nën mjergull, udhëve të reja prej balte
vetvetes më shumë i ke besuar.

Dhe je mësuar me ndërrimin e turneve,
vjollcë e saldafricëve më s't'i vret sytë,
me zogjtë të ngjajnë montatorët lartësive
dhe nuk çuditesh si dikur me yjtë.

Ti s'je më gjimnazistja e vogël
me ëndrrat lulemolle e erëftua;
tani jëmi më tepër se atëherë,
pafundësisht të lumtur burrë e grua.

VRASJA E BUJKUT

...U lëkund si lis pa jetë
dhe ra.
Parmendë e vjetër
nga toka ngrënë,
mbet e palëvizur në brazdë.
E vranë në atë perëndim lufte
për misërniken

që shokëve të çetës
në male u kish d'hënë.

(Ç'u përgjak perëndimi!)
Qielli duket u përbys,
yjet në faqe malesh ranë,
kallëzatëndrra, yje iu bënë.
Lulekuqet që çelën atë çast
rrënjet thellë i kishin në dheun e shkrifët,
që më i purpurt u bë.

ALIAKSE BRAZDAT

Brazdat e lëna përgjystë u përgjakën tek përflakej agimi.

Në to po mbillej LIRIA:

(Që n' përgjyk beq' këtia)
Gjelli se jasht n' përgjyk
Vjell n' që tash qëndroj mëng
Këtijas (këtia) këtia këtia
Përnikat e dëgj do këtia që është
Tëqendë tjetër i kësia n' qëndroj e spiktor
Përditës i tjetri i kësia n' qëndroj e spiktor

K E N G E T

Lumenjtë verës rrjedhin të qetë,
po rrugën e derdhjes e mbushin me shushurimë.
Këngët, duke u derdhur nga zemrat në jetë,
nëpër tinguj jetën përtërijnë.

Rrodhën e rrodhën ato nëpër mote,
edhe kur jetë derdhëtë lot.
Ne i zbrazëm këngët prej shpirtit gjithmonë
i mbushëm ato me zjarr e barot.

Lumenjtë verave rrjedhin të qetë,
po rrugën e mbushin me shushurimë.
Këngët duke u derdhur nga zemrat në jetë
nëpër tinguj jetën përtërijnë.

MIMOZA AHMETI

K R U J A

Ngrihen malet, hapen si xhokë,
retë si qeleshe mbi kokë,
tirqet e rrëpirës nga kjo tokë,
shihni Krujën time!

Lahuria gjelbërohet gushës,
dielli që nga mali i qesh fushës,
mes ullishtes fryn puhizë e muzës,
për ty, Kruja ime!

Netët përmbi kreshta kur rrëshqasin,
mijëra drita e ndezin tallazin,
tërë pallatet me kala përngjasin,
shihni Krujën time!

Autorja është nga Kruja, vazhdon vitin e parë në Fakultetin histori-filologji (dega gjuhë-letërsi).

Mes qytetit mbi kalë Skënderbeu,
thua paska dailë me vrull nga dheu,
për liri i ndritka shpatës tehu,
e lirë Kruja ime!

Mbi bedena ngrehur rri kalaja,
flet me gjuhë betejash të mëdhaja,
dielli i Partisë shkrepstin mbi majा,
përflak Krujën time.

N A I M I T

Ti u thirre maleve,
vlon kënga në male,
u këndove fushave,
fushat hedhin valle,
ti u qeshe luleve,
u mbushën petale.
Në vargjet e tua,
zogjtë cicerojnë,
mbi atdheun e lirë,
sot po fluturojnë.
I këndove punës,
të gjithë po punojmë,
sa shumë i dëshe,
ti shkronjat e arta,
pa i shiko shkronjat,
u bënë të zjarrita,
gjuha jonë shqipe,

më e mprehtë se shpata.
Si kandil u trete,
ti për Shqipërinë,
pa shiko sa lart,
ia ngritëm lavdinë.
Bujkut e punëtorit,
u këndove ti,
ata zot u bënë,
me nënën Parti.
Ty malli të dogji,
s'vdiqe në atdhe,
por atdheu të mori,
ja, sot je me ne.

P O E Z I A

Çelur si petalet është poezia,
shpirtrash të ndezur ku skuq dashuria,
kthjellët si Valbona në rrjedhë pranverore,
shpërthen ajo vrullthi si luledëbore.

Bardhësi e saj pastërti më fal,
për buzët e saj ngurrimi s'më ndal,
në ëndërrat e bardha të ditëve të mia,
si lumë i Valbonës buron poezia.

S'Í DÚA

S'i dua mendimet e pálosura
si sirtaret e pajës,
as si flokë të shkuara rrresht bigudinash
s'i dua,
mendimet le të shpérthejnë si gjuha
e mortajës,
le të blerojnë si barfolës
rudinash,
le të shkaperdrichen si gjoksshkumti
krua.

Dot emi tjetri s'ndezje
dot midazop e moxëg
dot s'ndezje mëlla t'ndezje
dot s'ndezje t'ndezje

GJYSHJA

Rrallëherë gjyshen e shikoj,
të heshtur, të menduar,
ka hyrë thellë, e kuptoj,
në motet e shkuar.

Sa shumë halë ka kaluar,
por i mungon ditari,
të gjitha gjyshja i ka shkruar
te rrudhat që i ka balli.

Po, shpeshiherë gjyshja lot me ne,
gëzon e qeshim tok,
na duket sikur është e re,
sikur e kemi shok.

Portreti i gjyshes s'mund të jepet
me një penel të vetëm,
ajo fal hije, ngjyra, drita,
që pasurojnë jetën.

VAJZË MOJ

Nën një bli që hesht në vjeshtë
rri pështetur, dikë pret.
Vijë e buzës sate, vajzë,
gjeth filizash mbi një brazdë,
sytë e tu — i kaltri det.

Futur nën një bli
pret të vijë ai,
ruhesh nga një shi...

KËRKVOA — GJETA

Kërkova në fijet e barit
thinjat e Shqipërisë,
kërkova në fijet e barit
flokët e shekujve,
në fijet e barit, gjaku i lirisë
u ngjante fjalëve, njerëzve
emrave.

Kërkova në fijet e barit
thinjat e Shqipërisë
dhe gjeta epikën heroike,
bile dhe të fshehta dashurish,
që frynin një puhizë lirike...

VITI I RI NË QYTEZË

Bardhësi bërë komplet i thjetor,
shkasin vogëlushët në udhë të kristalta,
tej xhamit me avull po ma bën me dorë
i vjetri vit tek shket përmbi borë.

Një vit i rizbriti në qytezë,
sonte askush s'tha natën e mirë,
sepse kur dëshën ta thoshnë këtë,
mëngjes i një tjetri vit kishte gdhirë.

DEGËZ GJELBËROSHE

Dega e hardhisë përkundet nga era,
si ajo unë jam,
plot ndijime bime,
unë s'shkund fëshfëritje
për këngë të tjera,
strofa vajzërie prej një tjetër rime.

Tundu lehtë, tundu,
degëz gjelbëroshe,
lehtë-lehtë përkundem dhe unë
në mendime,
farfuritjet tonë s'janë trille boshe,
janë çaste të bardha,
plot me ëndërrime.

MUJO BUÇPAPAJ

MALI GEZOHET

Mali godtahet kur lind qengji,
kur blegërin delja
e lëshon qumësht bari.

Mali fluturon prej lumturie ndër qiej,
lartësohet mali tej qiejve,
kur njeriu i buzëqesh çiltërsisht njeriut.

Mali shkrihet në çaste kënaqësie,
kur vjen pranvera mbi brigjet e lumiit,
kur shkrin dëbora e rrokulliset guri në shpat
nën këmbët e kaprojve të bardhë.

Mali godtahet,
kur mjelësja mbush bidonat me qumësht,

Autori është nga Tropoja. Vazhdon vitin e parë në Fakultetin histori-filologji (dega gjuhë-letërsi).

kur rrítet briri i dashit një pëllëmbë,
kur klith një foshnjë e re në shtëpitë e fshatit,

kur hedh çapat e parë një foshnjë tjetër,
kur rrëmbejn kërrabën e bariut të parën herë,
mali
gëzohet...

QE TE MOS ZEMEROHESH

Mëngjesi zgjoi ditën e sotme
me sqep të qukapikut mbi degëzën e njomë,
të shkurtra duken netët kur pret të bardhën
me këngë e freski nëpër kroje. ditë

Mbi kraharorin t nd kur ulet dielli
ulet kryet lehtas e largojn ,
sikur i druh n bukuris  sate
papritur te un  duart i afrojn .

Unë u marr erë, i ledhatoj me dorë
këto lule të këndshme, lule pyjesh,
i prek me dorë, por nuk i këput,
që ti të mos zemërohesh, të mos fyhesh.

KY MAL

Ky mal ka në vërvete
dhembjen e tërë njerëzve,
që e zbraz çdo natë
në puhinë e erës.

Ky mal ka në vërvete
këngët e tërë brezave,
që i zbraz çdo mëngjes
në gurgullimën e krojeve.

Ky mal ka në vërvete
gjakun e tërë të rënëve,
që e kujton çdo pranverë
me çeljen e trëndafilave.

D A U L L J A

Zëri yt vjen nga thellësia e kohërave,
zëri yt i rreptë si kohërat,
pas krismës sate mblidhen kruhq e nuse të reja,
pas krismës sate mblidhen burra lufte.

Krisma jote shponte tejpërtej malet,
lajmi i luftës tundte kullat e lashta,
lajmi i luftës i mblidhët djemtë një nga një,
«O bini burra të vdesim si me le!»

Nën krismën tënde mblidheshin për luftëra
burrat që shponin më jataganë qiellin,
u mblorehën dhe rrökën pushkët e gjata
e për tokën tonë lanë kockat e pikën e fundit të
gjakut.

DASHURINË TONË E NDIEJNË PEMËT

Diku në fshehtësi
pemët ndiejnë hapat e të dashurve
dhe hapin sythet.

Diku në largësi
ndiejnë zërin e të dashurve
dhe hapin lulet.

Diku pranë vetes
ndiejnë duart e të dashurve
i kuqlojnë mollët.

Pemët ndiejnë dashurinë tonë.

UNË I DUA ATA SY

Sytë e tu,
si dy pellgje uji
ku lahen zogjtë.

Unë jam pranë tyre,
jam i kredhur atje,
nuk dal dot në brigjet e tyre.

Pérkrah meje
shoqja ime punon
duajt e grurit
të mbështjellë prej qielli
me yje.

Në sytë e saj
fërfërin flladi në grunja
Unë i dua ata sy,
ku pikojnë yje prej qielli.

PËR SHOKËT

Një natë vere zgjuar
dhe kënga jonë e tretur në të,
në sytë e shokëve
dielli i ditëve tonë që udhëton.

Tani jemi diku larg.
në brazdat e tokës,
ku dielli shndërrohet në grurë
e në fruta.

Udhëtojmë
hapësirave të dashurisë sonë,
që na ftojnë sërishmi.

Si një klasë,
si një zile,
si një këng' aksioni,
si një diell vere.

Ditët rrjedhin
në oborrin e shkollës ku mësuam bashkë,
plëpat shndritin në diell
dhe rriten,
si dashuria jonë,
si rrugët tonë,
si ngrohtësia e diellit,
e dashurisë së shokëve.

PLEPAT RRITEN

Plepat rriten në oborr,
edhe malli ynë,
këngët janë larg.

Zérat tanë si zogj të vegjël
na kërkojnë ne në klasë.
Ne jemi diku pranë,
diku larg.

Dy duar
presin jashtë, zgjaten,
çasti i ndarjes.

Shokët kanë ikur,
gjethet kanë rënë tërë vjeshtës
mbi hapat tanë,
na i kanë mbuluar.

Mallin jo.

PËR JETË

Për jetë
ia shqyem hijën vdekjes
në netët e gëmëndura
të gjëmave të mëdha të kullave.

I zvogëluam dritaret
vetëm sa për të parë zemrën e hasmit,
që të mos na e dërgonte vdekjen.

I varëm në ballë të vatrës
lahutat me jele të vraçave,
që të mos na tremben dasmat.

I zbrazem pushket
në futën e zezë të natës,
qëjeta të na vinte e bukur,
me rroba vajze që pret të bëhet nuse.

— Aley këllë shëndetësia
— që më dëgjohet —

VALLTARI DELI

Sa herë në bjeshkë dëgjohen daullet,
rudinat i merr malli për Deliun,
e vjetrojnë barin.

Sa herë dëgjohet fyelli në bjeshkë,
ahet i merr malli për Deliun,
i lëshojnë krejt gjethet.

Sa herë dëgjohet këngë në bjeshkë,
krojet i merr malli për Deliun,
e shterojnë ujin.

Sa herë që hidhen valle në dasma,
njerëzit i merr malli për Deliun,
e shikojnë rrugën e bjeshkës...

Tani që ka vajtur në shkollë.

PREÇ ZOGAJ

TE SHTUNAT E BUKURA TE MALESISE

Një e nga një me çap të lehtë,
nuset vijnë tek vendlindja.
Dhe natyra krejt e blertë
befas u vesh me një mijë ngjyra.

Njérës i rrëzellejnë ende zinxhirat,
tjetra është me barrë të parë,
tjetrën e heqin pas fëmijët,
xhevahiret më të rrallë.

Uji i Veles pushon së ecuri,
çdo gjeth, çdo pellg bëhet pasqyrë,

Autori është mësues në fshatin Velë të rrethit të Lezhës.

mbi tokë si dielli mbi jetën
e derdhin dritë nusërinë.

Nuset trishtuan veg një të diel,
kur ia thanë lotët vajzërisë.
Tani malësia i ka për nder,
kur vijnë si perla të blerimit.

K T H I M I

Mbrëmja afron horizontin,
detin e largët, ishullin.
Malli që kam bëhet erë,
më afron gjithë vendlindjen.

Ishulli këndej, i gjelbër,
me fyejt e hareshëm të tokës
vë në gjumë zogjtë dhe fëmijët...
Atje kam nënën time.

Hëna del dhe hap qiellin,
u ndan unaza kallnjve
dhe ngjall hijet e bimëve...
Atje kam motrën time.

Nën hijet e lülevë, bimëve
rruzujt e djersës ndizën
dhe vështrohen më yjet...
Atje kam të dashurën time,

Atje do të vjen me vëllësi
Aja ka qenë qendrë i vëllërit - fëmijët, i vëllërit
që nuk ka qenë vëllësi, që nuk ka dashurë
në qytet, që nuk ka dashurë

NËN HARKUN E PLEPAVE TË BUTË

Atje në rrugën Lezhë-Manati,
nën harkun e plepave të butë,
vinte motra me një djalë të ri...
Ktheva blatishtes pa rënë në sy.

Dhe besova i hidhëruar
se ai më shumë se unë i shkonte në krah.
Lumturia e motrës më ftonte në gjëzime,
por lufta, lufta u ndez e s'më la.

...Stërgjyshërit si erë dimri,
me mustaqet si brirë,
ku zemërimi bën folenë,
më shpuan në brinjë,
mërmëritën: Luaj!

Gjyshërit — gjëmime luftërash
e gjithashtu lodra grash
u ngjallën nëpër genet,
urdhëruan: Luaj!

Babai flokëborë
tha: Mbaji frenat mirë.
Në sytë që mbylli fshehu
një qeshje, një dëshirë...

Atje në rrugën Lezhë-Manati,
nën harkun e plepave të butë,
vinte motra me një djalë të ri...
Ktheva blatishtes pa rënë në sy.

ME ATË TRILLIN PREJ POETI

Me atë trillin prej poeti
kërkoj një varkë të lehtë në sytë e tu,
krahët fluturues të zogjve,
detin e kaltër, diellin...

Ti kokën ngre dhe unë shoh
fytyrën time të qeshur...
Gjithë krahët fluturues,
varka e lehtë, dielli
sprapsen pak përparrë meje.

K E N G È

Vij e vij tek sytë e vashës,
përherë i dashuruar pas jetës.
Jam parë e krehur në ata sy,
jam zhhytur i tëri si në flakët e diellit,
ballë pér ballë, edhe larg shpeshherë, gjithnjë
zot i hareshëm,
se të ndieja pranë si shoqe jetë.
Përmes teje më mirë kam parë
përse është bërë njeriu;
pér të shpjeguar botën dhe pér ta transformuar¹⁾.
Përmes teje i pashë të bukura,
të lehta detyrat e mia.

1) Varg i Pol Eluarit.

Me se s'merret mendja,
ku s'mahnitet shikimi!
Këtë kohë, në këtë vend, s'ka zbrazëti një sekondë,
edhe kur qepallat ulen mbi sytë me gjumë
pulsi i kohës në zemra rreh fort.

QAZIM SHEHU

SHËTITJE ANËS HEKURUDHËS

Shëtis rrugës së Mqedës,
këtë mbrëmje shtatori,
dhe me zërat e jetës,
më mbushet kraharori.

Ndriçon përballe Va-Deja,
me një unazë dritash,
më flet për figura të reja,
dhe për tituj lirikash.

Ndriçojnë shtëpitë dyvjeçare,
të ngritura pas tërmefit,
ndriçojnë fjalët amtare,
në vargjet e Ndre Mqedës.

Autori është nga Librazhdi, vazhdon Fakultetin histori-filologji.

SHKALLA E KUQ

Ndriçon kapanoni me të rinjtë,
dhe me sulmues të ditës,
ndriçon lokomotiva,
me sytë e saj përshkënditës.

Ndriçon tutje Taraboshi,
ndriçon zemra e studentit,
ajo ka rritje nga Vrmoshi,
dhe trimëri nga Kelmendi.

Ndriçon kjo fushë trime,
me këto ecje orësh,
me reflekse në shina,
prej semaforësh.

TINGULL I HEKURIT DHE I GURIT

Sa herë kur në auditor të ulemi,
do të na vijë në mendje shpesh
tingull i hekurit dhe i gurit,
si një melodi që na u mësua në vesh.

Sa herë kur librat të hapim,
porsi valët e shpejta të lumit,
kur do të lexojmë vargjet e pastra,
do të kërcasë tingulli i hekurit dhe i gurit.

Sa herë kur të ecim udhës,
në pranverë, gusht ose vjeshtë,
do të na vijnë këta tinguj hekurudhe,
si një imazh madhështor, nga Mjeda.

RRËFIM I QERRTARIT PLAK

Ja, ky është fshati ynë,
tha qerrtari plak,
shtëpitë e bardha nxjerrin tym,
nën pemët varg e varg...

Fshati ynë hallemadh,
dikur mos pyet si ishte,
çatia e kasolles së thantë,
një metër mbi gardh vinte.

Ishim ne të varfér atëherë,
të varfér 'sa më s'ka,
togje kashte vinim në vend të derës,
dhe sëmundja bënte hata.

Baltrave i mbollëm eshtrat,
dhe gjunjët na u mbushën me ujë,
me lëpushka i mbushnim qerret,
dhe muzgu na shtinte krupë.

Mbi kurriż vlonte kamzhiku,
dhe fjalët fyese pa pushim,
po një ditë në plumb,
e kaluam gjoksin e beut tim.

URA E RE MBI DRIN

Eshtë kjo urë pa një legjendë,
urë e paharqe, pa mozaikë,
por trupin e fuqishëm e nden
në dy brigjet e lumi Drin.

Betoni që ne i gatuajmë,
hekurat që ia lidhim fort
dhe kallot tonë në duar
do ta bëjnë të rrojë jetë e mot.

Do fryjnë mbi të erërat.
Trenat do kalojnë me shpejtësi.
Këtë urë e lidhën muskujt tanë,
ndaj do të ketë gjithmonë rini.

RITVAN DIBRA

FËMIJËT DHE DETI

E shikoni atë vogëlush
me një copëz deti në sy,
që ndjek me kureshtje vallen e valëve
me kaq èndje, me kaq èmbëlsi?

Ai vogëlush i ulur mbi fletë,
ndoshta nesër do të bëhet poet.

I shihni ata fëmijë të qeshur e punëtorë,
tek ngrenë me rërë urat kështjella?/
Ndoshta nesër, veshur me kominoshe,
do të na buzëqeshin nga minierat dhe skelat.

Ata fëmijë me lundërza prej letre,
(porsi deti të pastër e të dlirë),
që èndrra i hedh në udhëtime të largëta,
me siguri do të bëhen detarë të mirë.

Autori është mësues në Fshat të rrëthit të Kukësit.

V A L E T

Ngrihen valët nga gjoksi i detit,
plot hov, vrull, lart e më lart...
Dhe përsëri bien në gjirin e tij,
si fëmijët në gjirin e ba'bait.

Ngrihen valët e ia thonë këngës,
ca me mërmërimë, ca me zë të fortë.
Deti rrudh ballin e bën vlerësimin;
kjo ish psherëtimë, kjo stuhi e shqotë.

Nga gjiri i madh i popullit-det
ngrihen poetët si valë
dhe bien përsëri në gjirin e popullit
për t'u ngritur pastaj dhe më lart.

VAJZAT E NDËRMARRJES ARTISTIKE «MIGJENI»

Ishte skenë, a fushë me lule
valle ishte, a shpërthim pranverë?
M'u duk se kishin zbritur
dhjetë, pesëmbëdhjetë ylberë njëherësh.

Ushtoi daullja si bubullimë,
u prish i ylberit spektër.
Një vajzë përshëndet diellin me shami,
thua se fluturon një tjetër.

Pastaj vallja nis e qetohet,
nën një daire, nën një violinë,
thua se dhjetë dallëndyshe
nisen lehtë për fluturim.

Thua se dhjetë dallëndyshe
në skenë vijnë radhë-radhë...
Po t'i shihte Migjeni ynë
ç'poezi do të thurte vallë?

N E R E Ç

Një mëngjes të bardhë fshatarët e Reçit,
diku në një shesh, poshtë hijes së maleve,
mbollën një pyll me gështenja të larta
dhe i vunë emrin «Sheshi i Gështenjave».

Pikojnë tani në vjeshtë gështenjat
dhe fëmijët dalin e i mbledhin fushës.
Por ndodh shpesh që bashkë me gështenjat
fëmijët mbledhin dhe gjëzhojat e luftës.

L I R I K E

Të kujtohet ajo mbrëmje prilli,
tek ecnim pas punës, e dashur?
Në qiellin me yje, një re e bardhë
si gërshet hënës i që varur.

Dhe më dukej se thoshje e qeshur,
me sytë që ndrisnin nga gjëzimi:
«Cili gërshet është më i bukur,
ai i hënës a ky i imi?»

Dhe unë mendoja atë natë me vete,
kur sakaq fryu erë e fortë;
gërsheti i hënës u zhduk në qiell,
ndërsa i yti mbi shpinë po lot.

NE THETH

Thethi në mes si dhëndër,
malet të rëndë madhështorë...
Si të jenë shtruar në një sofër
e pinë të gjëzuar si dasmorë.

Përballë ngrishen prapë majë të larta,
të mprehta, të thyera, krenare...
Si kardiograma të lashtë
të zemrës së tokës shqiptare.

KËMBANAT

Keni parë këmbanat në muzeun e Durrësit,
diku në një qoshe hedhur pa kujdes?
Janë si një tufë plakash memece, që koha jonë
i flaku
dhe me darën e revolucionit gjuhën ua përdredh.

E di sa do të dëshironin këto këmbana,
t'ia nisnin këngës së tyre përsëri.
Dhe si dikur, në mendjet tona
të mbillnin ankth, trishtim, mërzi.

Ndaj sot në muze i mbajmë,
ca nesër në furrnalta do t'i shkrijmë.
Dhe do ta ndiejnë ato peshën e forcës sonë,
peshën e rëndë të trenave mbi shpinë.

RRAPO ZGURI

KUJTIMET E VENDLINDJES

Ndodh që harruar ato flenë në kujtesë
si valët që flenë në një det të qetë.
Po mjafton një zë, një pamje a fytyrë
dhe ato brenda teje brofin shpejt e shpejt.

Marrin udhë nën flladin e ëmbël të mallit,
që njëra pas tjetrës i zgjon, i përpjek.
Dhe plot me gaz drejt vendlindjes rendin,
si valët që flladi i shtyn për në breg.

Autori është nga Dumreja. Vazhdon vitin e parë të
Fakultetit histori-filologji (dega gjuhë-letërsi).

B U J K U

Nën hijen e një rrapi, pranë një burimi,
ndanë arës me grurë, ku qeshte gjelbërimi,
u ul ai dhe zogjtë ç'i këndonin.
Dhe pushkë e drapër pranë bisedonin.

Dhe nxori nga torba bukën e grunjtë
me duart e ashpra, plot me dashuri,
me të ish përzier dhe një copëz dheu,
kafshatë nga toka, nga zemra e tij...

S'e flaku tutje dheiun me inat,
por bashkë me bukën e mbajti në pëqi.
Dhe ndot nuk do të kish sikur me kafshatën
pak dhe të bluante nëpër dhëmbë ai.

AKUAREL PRILLI

Mbushen plot pér plot lumenjtë,
si nga shirat në ditë vjeshtë,
pák dëborë të bardhë malet
majës mbajnë, sa pér qeleshe.

Serioze kjo natyra
ish nën bërrucin ngjyrë gri.
Por tani qesh si fëmija,
sapo vesh fustan të ri.

Që nga sythe frymëzimi
këngë të reja po gjethojnë,
arat ëndrra rëndimenti
nën fllade shpesh shikojnë.

Nëpër nete pikon hëna
dritë të verdhë, nga qielli i heshtur,
porsi hurmë në nëntor
që pikon nga degë e zhveshur.

AK-HISSAR

Trokëllima mbi Egnatia,
zhurma qerresh dhe rrëmuje,
re e pluhurit ndjek prapa
gjysmëhënën mbi flamur.

Dy lumenj po shkojnë pranë:
ndanië taboresh të pacak,
shkon Shkumbini në një anë
turbulluar, zemërak.

Duke rendur mes luginash
njëri ujët derdh në det,
tjetri rend mes hingëllimash
valët derdh tek vdekja e vet.

Tek rreh bregun, valë e ujit
shushurin dhe ngre stërkalë,
valë e çallmave në brigje
murmuriu: — Allah, allah!

Kështu erdhën radhë-radhë,
duke shfryrë Ak-Hissar¹),
pranë mureve të tua
tri rrëthime, tri sultanë.

Lak i hekurt përreth teje,
lak në fyt të Arbërisë.
Para portash nxiu tri herë
çallmë e zezë e robërisë

1) Ak-Hissar — kështjellë e bardhë. Kështu e quanin osmanët Krujën.

Po s'të theu kafshim i gjyleve,
as dhe sulmi më tinzar.
Tri rrëthime të prunë zinë
ti tri herë: — Ak-Hissar.

Edhe mbete, vç e bardhë
me bedenat në lavdi.
Ak-Hissar, në vjet e shekuj,
Ak-Hissar në histori.

KËNGA HIMARIOTE

S'e kuptoj papritur si u ndodha
në një breg të rrallë, plot shkëlqim.
Ç'është ky fillad i ëmbël?
Ç'është kjo valë
që kaq ngrohtë të fton në përqafim?

Det i gjérë ti këngë himariote,
iso e thellë, joniarie, e pafund.
Brigje zemrash rreh kjo vala jote,
brigje zemrash vala jote shkund.

«Moj nepërka pika-pika» — përcjell era.
Flladi fryn në bregun plot shkëlqim.
Si të rrish në breg kur vjen kjo valë,
që kaq ngrohtë të fton në përqafim?

Q E L E S H J A

Kaq vjet mbi kryet tona
ti zbardh si dëbora në majë.
Atë nuk e shkrijnë dot kohërat,
ty dot nga ne nuk të ndajnë.

Nën ty mendim i shqiptarit
më i sigurt, më i shëndetshëm ish.
Ashtu si kërcellhit e grurit
nën dëborë mes dimrit me ngricë.

Ka qëlluar që shpesh nëpër luftëra
prej gjakut mbi krye je skuqur,
por asnijëherë nuk je nxirë,
asnijëherë nën këmbë s'je ulur.

Kaq vjet mbi kryet tonë
ti zbardh si dëbora në majë.
Atë nuk e shkrijnë dot kohërat,
ty dot nga ne nuk të ndajnë.

TRENI I PASDITES

Mysafirë të rinj i solli Tiranës
ky tren i mbasdites, sot.
Njatjeta!
Pallatet zgjasin ballkonet,
si të zgjasin duart në një takim të ngrohtë.

Hapa të nxituar,
valixhe pendë të lehta.
Fytyra të përmalluara, që ecin drejt qëndresës.
Këtu syri nuk hapet nga ndonjë bukuri përrallore,
por nga që është
më afër zemrës.

SAMI GJOKA

SHPIRTI I FSHATARIT

Ky avull që po më del nga rrrobat e qullura,
sa shumë më ngjaka me avujt e ügarit
e prej erës, e prej shiut flokët e ngatërruar,
ç'më ngjakan kaq shumë me barin e livadhit.

Trupi kundërmoni aromën e tokës,
pluhurin kur mbyt njëpi imët shi,
erën e silazhit nxjerr avulli i tokës,
shpirtin e fshatarit kam thellë në gji.

Autori është kooperativist në Manzë të rrëthit të Durrësit.

NË MINIERËN E GËRDECIT

Gugatja e bretkosave gjer natën vonë,
hëna e trishtë qëndronte mbi luginë...

Po rrëzohej vëtmia e asaj lugine
si një lis me rrënje të dala,
vinin djem e vajza me makina,
si në mars manushaqet e para.

U dëgjuan lopata, kazma, që goditën
dhe gremisën lashtësinë. U zgjuan këngët,
ndërtesat e para të minierës u ngritën.
Përjeton kjo luginë çaste lumturie
tek dalin nga nëntoka
me qymyr e me gëzim ngarkuar
vagonat e rëndë.

МУЗИКА В АРДАСИ

Казмат, ррапалитен нё zhavor,
асфали гjer кёту do тё vijë.

Te kjo luginë,
te kjo ish-shkretëtirë нё mes тё pyllit
jeta dallgëzoi edhe thellë galerive.
Verbohej nga drita sy i zi i natës,
që ikte тё fshihej нё guva e brinja.

NJERIU I LARTËSIVE

Mbaj mend kur nise shtegtimet kaltërsive,
zogjtë ende fluturonin me mündim
dëmtuar nga ciflat e shpërthimeve,
shtëpitë gërmadha nxirrnin ende tym.

...një qytet që
Kalonin vité, miseshin udhëve të gjata...
mbi skelë lumturojë ti qdot stinë, perfosur
...fluturaket nga vendi fortitë largëta
vinin, prapë të linin në hapësirë.

Vështrimi yt — bardhësi agimesh,
qiell i kaltër dashuria jote,
rëndë në pafundësi shtegtimesh
për këtë tokë e kurrë s'u lodhe.

ЭТАН САРА I МАЛЛ НАНАДИЯ ЗИ
M A L L

Vajzës nga qyteti në breg të Erzenit

Ky kopsht' në këtë shpat kodre kundërmon
aromën e mollëve të pjekura,
dy sy të bukur një mall ç'm'i zgjon,
si pranvera dy sythe të fjetura.

Dhe ç'më zë dhe ç'më ngre peshë një èndërr
e bukur, si vajza e atij qyteti,
në shportë posa hidhja një kokërr të pjekur
varur sipër degësh një dëshirë më mbeti.

ME RRËMBEN KUJTIMI I ASAJ NATE

Sa herë qdha më bie këtej,
këtu ndaloj hapin dhe mendoj,
më duket se gjithmonë këtu të gjej,
natën e asaj vjeshtë rri kujtoj.

Ullintjtë ulin degët ngadalë-ngadalë,
nën ta zbuloj një tendë që s'është më,
hapet e më rrok një i dridhshëm mall,
ngrihet më thërrët një i largët zë.

Këtu nën ullintjtë e blertë një natë,
dasmorët ku hiqnin vallen të gëzuar,
vështrimi yt porsi fllad aqimesh
në zemrën time kishte vrapiuar.

ДИНАМІЧНІ ПІСНІ

Rastësish t nje dasmë u takuam,
si dy zogj që takohen t nje pemë,
t nje kryqzimet e vështrimeve tonë
një lidhje zemrash e fortë kishte rënë.

Kur u ndamë, gjithçka më qartë kuptova,
mes njerëzve kërkova sytë e tu,
me lulërinë e ëndrrave të mbulova
të dua, të dua, të dua...

MËNGJES NË MANËZ

Zogjtë çapkënë cicërojnë e çukatin degëve,
ndërsa drita si mbi pambuk zbret ngadalë.

Hap krahët të rrokë në gjirin tim këtë quell të
kaltër, ndjenjat, ëndrrat, dashuria për fshatarët më
përfshak.

Ja si ky diell që ngroh sot në Manëz,
prushi i vargjeve ato i ngrohtë kudo,
në gjakun e ndezur të qdo fshafari pakëz
zjarr do të marr, poezinë të ngroh.

VAJZAT E FSHATIT TIM

Si tyl i hirtë mbi lugina,
ngrihet mjergulla mengadalë,
qeshin 'sy, ndritin fytyra,
bashkërisht punojnë në arë.

Dhe kur djeg zhegu i vapës,
kur udhë, e pemë, e brigje mbushen
me cinxërimën e gjinkallës,
nën hijen e manit ulen.

Rrëshqet ora përmes gjethesh,
zë i tyre shushërin,
dhe vështrimet dritë ylberesh,
nisin rrjedhën në retinë.

Mbi gjergjefët borë të bardhë,
s'bien më lot pikëllimi,
çelin ëndrrat radhë e radhë,
posi lule mes blerimit.

NATE VJESHTE NË STAN

Kënga vjen që nga poshtë,
ku llamburit plot drita fshati,
ëmblas, si uji i burimit
rrekezëlet kur zbret nga shpati.

Natëron kopeja shtrirë,
rri dëgjoj tingujt e kengës,
malli shkon nëpër hapësirë,
gjer tek yjet përreth hënës.

Dasmë bëhet, hedhin valle
djemtë pëllumbë, vajzat yje,
unë çobani ruaj të bardhat
dele sonte lart në pyje.

NE KLASE

Çugurasin kokulur mbi libra,
një gumzhimë e këndshme mbush klasën,
bie nata jashtë. Pika shiu
në kristalin e xhamave përplasen.

Eshtë përqendruar mbi tekst shoku im,
të gjithë jemi kthyer nga të mbjellat,
ngriti kokën shiun porsa ndjeu,
sikur të kish rrokur gjithë pranverat.

E kërkonte kjo mbrëmje këtë shi të butë,
fara e kërkonte në dheun e vlagët,
sytë fluturuan tej xhamave në muzg,
një ballon gëzimi peshë e ngriti klasën.

SIMON VRUSHO

JAM LIDHUR ME TY

Më tepër se dita me diellin,
Parti, jam lidhur me ty.
Mes nesh s'mund të hyjë asnje re,
s'ka asnje të çarë,
ku me kollën e saj të hyjë e ftohta,
megjithatë mes nesh ka vend,
ku të futet me të gjithë shqetësimet bota.

Jam lidhur me ty
më tepër se mishi me kockën,
më tepër se gjaku me dejet.

Autori është mësues në shkollën 8-vjeçare të fshatit Velçan në rrethin e Beratit.

TRAKTORI SHQIPTAR

Duart si plugje lëronin metalet,
skicat, projektet, ç'ish e ç'nuk ish.
Zjeu në mbledhje kazani i debateve:
traktor,
në duart është uzinës ti do të mbish.

Nga balli i uzinës shqetësimi rridhte bashkë me
djersën
dhe që në projektet një zhurmë traktori ndihej.
Kështu mes magjes së metaleve, morisë së
skicave
traktori ynë i parë po ngrihej.

Gjithçka për ty traktor, për ty bükë
mbi gjumin e shkrirë, mbi metalet e tretur,
gjersa ti i buçite veshit të kohës dhe fillosit
së flamujve,
o fakt i hekurt!

E P J O S I

Në një pllaje, në periferi të Trojës,
me afsh Epjosit¹⁾ preu të sajat drurë.
Nga dërrasat dihet, lind një djep,
por një kalë dihet, nuk lind kurre.

Por ndodhi më në fund ajo, e papritura,
siç janë të papritura gjithë tradhtitë,
në zgavrat e syve të kalit prej druri
tradhtia këbshefi i nxirrte sytë.

Kështu ndodhite, kur pas dhjétë vjetësh
trojanët e quanin të përfjetshme lirinë,
harronin se pyjet e bukurë të tyre
në duart e grekëve shihnin lémerinë.

Harronin atar se gjérat, më të zeza
të bardha si ky kalë shfaqen para syve
dhe si të gjitha gjérat e pabesa
hi u hidhët shikimeve të tyre.

Ndërsa trojanët u verbuan, grekët
zjarre atyre u ndezën në sy,
dhe ç'të shihje mbi bedenat aherë:
në vend të ushtarëve, flakë kish aty.

Atë natë Epjosi, në periferi të Trojës
pa flakët, buzëqeshi dhe ra në gjumë,
ndërsa zjarret Trojën mbulonin,
ndërsa gjithë nata binte erë shkrumb.

TROJË, KURBANE

Trojë, kurbane pér nijë 'kalë druri,
kurbane tē bënë kundër jetës sate.
Tani n̄e vend tē bedenave prej guri
te zgjuarsia e popujve tē rri emri.

Algo është që e mëshkoi që dëgjohet

Algo është që e mëshkoi që dëgjohet
që mësimi i shkollës së lindjeve
e mësimi i shkollës së vjetër e lindjeve
që mësimi i shkollës së vjetër e lindjeve.

Algo është që e mëshkoi që dëgjohet
që mësimi i shkollës së lindjeve
e mësimi i shkollës së vjetër e lindjeve
që mësimi i shkollës së vjetër e lindjeve.

1) Af që bëri 'kalin' e Trojes.

PAVDEKËSIA JONE

Kur Hrushovi vetë s'na gëlltiti dot,
bllokada, mendoi, do t'i gëlltisë patjetër.
Ndërkaq, nga agjensia TASS, kryqëzata e
shpifjeve niste drejt nesh fluturimin e saj të egër.

Por skuadriljet e zeza të shpifjeve
qiellin tonë të lartë s'e arrinin.
Frazat e tyre të përgjergura
matanë piramidave tona binin.

Me ato fraza i mbushnin gojet
e kundër nesh i hidhnin armiqtë tanë.
Kur ne goditjen atyre u jepnim,
ç'dhimbje kanë ndier më zverk ata vallë?

Ndërkaq na doli para blokada-murtajë,
ne vinim në punë, në ecje këndonim,
ndërsa idealin e ngrinim më lart
urrejtjen e hidhnim mbi Hrushovin.

Eshtë fakt, ne fituam
sic të fituam dhe ty, pavdekësi,
ndërkohë një epos të rivlavdie
për ty kush ngritur populli, mój Parti!

F A R A

Në dorën e fshatarit
fara.
Fara në dorën e me dhe; ajo zbutet nga frymëmarrja e tij
dhe erë bukë vjen.

Dhe diç i thotë dorës, pëllëmbës, si sythet e pemëve në prill, në maj. Ajo diçka i thotë dhe zemrës dherdhës së bukur në ballë.

Në dorën e fshatarit
fara.
Mendova:
sikur më gjatë në pëllëmbë t'i rrinte
me siguri aty do të mbinte.

URA E GORICËS

Kanë thënë se Kurt Pasha e ngriti
para shumë e shumë vjetëve,
por dihet me shumë siguri:
ai asnjë gur s'ka prekur vetë.

Po kush e ndërtoi këtë urë
në këmbë të lagjes Goricë?
A s'i pagoi kjo lagje gurskalitësit,
kur pashai paguante rospitë?

Kur kjo lagje dy male guri
nga supet i zbriste në brigjet,
ne kalin me shalë ky Kurti
tundej tek shihte çifligjet.

Dhe kështu që nga themellet
gjer te parmakët, në krye,
«Urë e Goricës», e quajtën njerëzit
dhe valët e Osumit mes tyre.

XHUEL! XHUEL!

— Motiv "popullor" —

Delet majë malit kishin' dale,
aty dhe çobani.

Bjeri fyellit, delet i thanë,
bjeri fyellič, i tha sedhë bari.

Por çobanit vdekja i érdh'
kur në sy e kish Xhuel' i vogël.

Kush do ta ndillte qenin e mjerë
kur ai të ikte nga kjo botë?

Se fyellit, tha ai, i bie era,
se aty jäm çdo dele do kujtojë;
oh, të bëhem zog dhe Xhuelin
ta ndjell, ta përgëzoj!

MBI BEJTEXHINJTE

Kur Naimi shpatë e bënte vargun
e robërinë godiste mespërmes,
ata murmurisnin me zë të zvargur
bejte në mes të kafenesë.

Kur ata lotonin për sy vajze
dhe për vdekjen ngrinin rubai,
në sy Naimi kishte malet
e Skënderbenë të gjallë e kish ai,

E vinte Skënderbeu prapë në Krujë
që lufta të niste ashtu si dikur,
kurse bejtexhinjtë binin në gjunjë
e mekeshin për Mekën, për një gur.

CYTOI KUNDAN VIMONTAVE NE GURUA
SINTES

Kur mbi supet e vargjeve të Naimit
binte dhe binte pluhur lufte,
pluhur binte dhe mbi bejtexhinjtë,
por ky ishte i harrimit pluhur.

Në këto qytetët
është veshur qyteti i vjetër
dhe qyteti i ri.
A
qyteti i vjetër
dhe qyteti i ri.
A
qyteti i vjetër
dhe qyteti i ri.

Qyteti i vjetër
dhe qyteti i ri.
A
qyteti i vjetër
dhe qyteti i ri.
A
qyteti i vjetër
dhe qyteti i ri.
A
qyteti i vjetër
dhe qyteti i ri.

GJYQI KUNDËR VRIONASVE NË QAFËN E SINJËS

Çdo luftëtar nxjerr akuzën-shpatë
në Qafën e Sinjës me suferinë;
koka bejlerësh tē mbështjella me çallmë
ngjajnë si fermane që mërdhijnë.

Nën këto çallma a s'është Tanzimati?
A s'fshehin ato tymjake, xhelepe?
A s'mbulojnë ato tradhtinë e lashtë,
që sot do ta korrë drapëri-urrejtje?

Ja, si një gjysmëhënë e verdhë
çdo gjysmëballë poshtë çallmës duket.
Stuhia e akuzave fryn paprerë
e kokat-bejlere i lëkund mbi supet.

QAFËN VËRË

QAFËN VËRË

Në Qafën e Sinjës, qafat e bejlerëve
u drodhën, kokat në pluhur ranë,
ndërsa çallmat-bosh i rrëmbente era,
Stambollit, sic duket, t'ia shpinte si lajm.

Shkruan: Dritëzgjatë
dritëzgjatë
dritëzgjatë
dritëzgjatë

Shkruan: Dritëzgjatë
dritëzgjatë
dritëzgjatë
dritëzgjatë

Shkruan: Dritëzgjatë

SINAN KËRPAÇI

ZËRAT E FËMIJËRISË

Dhe kur rrri e mendoj vjersha,
dhe kur jam me shoqerinë,
ca zëra që s'më harrohen
nëpër veshë më cicërijnë.

Ca zëra, ca vogëlushë
nga fshati pranë më vijnë,
u rrita u bëra burrë,
po me ta bëhem fëmijë.

Eshtë fëmijëria ime,
që më gjen dhe në Tiranë,
këto rima këto ritme
zëra shokësh le të mbajnë.

Autori eshtë oficer në Gjirokastër.

SHQIPTAR

O tē vegjelit e rritur
vend dua, t'ju bëj, në vjersha
dhe mbi abetare shtritur
dhe pas një topi me lecka.

Mu ashtu siç kemi qenë,
pa teprime asnje grimë,
dhe tē qetë po, dhe çapkënë
si përrenj me gurgullimë.

Shqipëri i lindur i përitur
në qytetin e Durrësit, i cili
në kohët e lashta është qyteti më i madh
i Shqipërisë, i cili ka qenë i rëndësishëm

PIANISTJA E VOGËL

Me duar që hedhin valle
përmbi piano sa më rritesh
ti, si artiste e madhe
ule e harron të ngrihesh.

Këta gishta kaq të njomë,
këta gishta kaq të vegjël,
me këto zëra që zgjojnë
rrëth e rrëth këtu na mbledhin.

Ata tinguj lart të ngrihen
si thëllëza tufa-tufa,
aq të qetë, aq të rrëmbyer,
sikur të dalin nga buza.

“Babi sipér ja kù është,

Babi sipér ja kù është,
që nga skela shikon ty,
të afrohet qetë-qetë
më çekan e më fëmstri.

“Babi sipér ja kù është,
që nga skela shikon ty,
të afrohet qetë-qetë
më çekan e më fëmstri.

“Babi sipér ja kù është,
që nga skela shikon ty,
të afrohet qetë-qetë
më çekan e më fëmstri.

“Babi sipér ja kù është,
që nga skela shikon ty,
të afrohet qetë-qetë
më çekan e më fëmstri.

QENIT TË STANIT

Po si nuk më njohe, o qeni im i mirë,
atë natë kur te dera e stani të endha!
Brenda vetes për ty kisha mbledhur sa mall
dhe në vesh më kumbonin sa të lehura!

Si nuk më ndjeve erën menjëherë,
po shfryve rëndë si për t'u turrur,
nën hundë.

Po unë nuk mërzitem, s'të vë faj,
e ku ta dije ti se çdo t'isha unë!

Nuk ika një ditë për të mos ardhur më
dhe për ty hiç fare mos të kisha mall,
se pas tufës së dhive në pyjet e bukura
ta derdhja mbi gurë paguren me dhallë.

SHALLOI NJE DITE TE SHIHJA NJE GJAHTAR

...Më qëlloi një ditë të shihja një gjahtar,
që me langoin e tij përpara më shkoi,
dhe thashë për qenin me qafën e gjatë:
qenit tim të stanit s'i vjen as të thoi.

shihja
një gjahtar
me qafën e
gjatë

shihja
një gjahtar
me qafën e
gjatë

VJELESJA E PORTOKALLEVE

C'je moj ti me atë shportë
të mbushur me portokalla,
m'u shfaqe përpara sot,
sikur dole nga përralla.

Po ti s'dole nga përralla:
moj thëllëzë ku je rritur!
Mu atje nën portokalla,
vajzë keq më ke goditur.

Nga më erdhi kjo goditje,
ç'qe ky plumb i përvëluar!
Thëllëzë që rri në pritje,
syri yt më ka qëlluar.

Një si ti në jetë desha,
ndaj nuk kënaqem së pari,
që të më futej në vjersha
duke shkundur baltë ugari.

BISEDAT ME TELEFON

Telat nderen nëpër shtylla
dhe mbi kodra dhe mbi fusha,
ja këtu që nga kabina
zemrën plot me ty e mbusha.

Jo, në zemër ty të kisha,
kemi kohë që rrimë tok.
Tani me shokët kur isha,
zemra më hidhej si zog.

Ne të dy te njëri-tjetri
kemi kohë që kemi hyrë,
mallin në fijet e telit
bëj ta shtyj, po s'ka të shtyrë.

Po dy-tre minuta ç'janë,
për të folur ne të dy,
në çdo ditë sikur më pranë
vjen tek unë e vij tek ti.

FUSHËBARDHA QË TË BARDHËN E KISH VETËM NË EMËR

Liria e atdheut kur kërkonte njerëz,
vendlindja ime s'i kurseve bijtë,
të bardhën, që ti e kishe veç në emër,
ngjyra e kuqe e nxori në dritë.

Nëntoka kish thesare, mbitoka qe e varfër,
e bukura e varfër vendlindja ime ti,
një ditë që njoha veten, kur ndjeva dorën tënde,
lëvizi ibrenda meje një mal me dashuri.

Kur unë të thirra nënë, ti ishe bërë nuse,
më zbrite nga djepi, më tunde në male,
te një rrudhë e bukur që kishe te balli
nisi rruga ime dhe u zgjat si valle.

Ja, shami e nënës, hige vallen tutje,
si të kam mësuar ta hedhësh në thua,
unë në çdo hap timin nëpër rrugën time
pas sikur dëgjoj: bir sa më ngjan mua.

Jo sikur dëgjoj, ky është vetë zëri,
se ti rritjen bijve ua mat gjithë rrugës,
dhe kur dielli lind në Mal të Gjerë,
dhe kur perëndon në majë të Lucës.

VASIL DILO

RRUGA QË ENDET MBI ÇATI

Ju, që e keni parë këtë rrugë,
thoni, ku ka tjetër të tillë, ku ka?!
Ti je e vetme në botë,
moj rrugë belholla nën kala.

Qyteti të jep nga frymë e tij,
nga heshtje e saj të jep kalaja,
ti shkon e brishtë mbi çatitë,
ti rend e lehtë nëpër majë.

Stinët pas teje u harruan
dhe nisën grindjen një ditë,

Autori punon aktor në teatrin dramatik të Gjirokastrës.

po ti rishtas i pajtove,
moj rrugë që endesh mbi çatitë.

Të fshehtat e tyre t'i tregojnë
të rinjtë që vijnë shpesh aty,
Askujt s'iä thua ti ato,
askush vec teje nuk i di.

S H O K E T

I lamë karrot dhe lopatat
e zbritëm poshtë në xhade,
atje ka ardhë autoboti,
që ujë sjell çdo ditë për ne.

Shokët pinë një nga një,
na lanë të fundit ne të dy,
në dorën tënde, të thashë unë,
do doja ujin që ta pi.

Ti buzëqeshe, dhe i vure
duart e tua pranë e pranë,
unë do të doja që ai ujë
të ish pa fund, si oqean.

136. Këshu përditë na lënë shokët

Këshu përditë na lënë shokët
të fundit mua 'edhe 'ty,
një herë të pimë në duart e tua
një herë të pimë në duart e mi.

137. Këshu përditë na lënë shokët
të fundit mua 'edhe 'ty,
një herë të pimë në duart e tua
një herë të pimë në duart e mi.

138. Këshu përditë na lënë shokët
të fundit mua 'edhe 'ty,
një herë të pimë në duart e tua
një herë të pimë në duart e mi.

DËBORA NË MINIERË

Ata u futën në ashensor,
e nisën të ngjiten sipër,
ora e dorëzimit të turnit kish bardhë.
Rreth minierës shtrihej dëbora
e pafund, si zemra e tyre e bardhë.

Minatorët mbetën dy grima pa folur,
vështruan tej
dhe kapelet i shtrënguan në dorë.
të befasuar ashtu siç ishin
filluan të luanin me dëborë.

Poshtë në minierë nuk ka qiell me re,
nuk ka pëllumba,
dhe dëborë nuk bie atje,
prandaj ata e duan qiellin
ndofta më tepër se sa ne.

HARQET E QYTETIT TIM

Qyteti im!

Ti nuk ngrite kurrë harqe triumfi,
se pas luftës
një luftë tjeter do të vinte
dhe t'i s'kishe nga të mirreshe me tò,
ndaj
në kubetë e pafundme që ndërtove
i pate përfshirë edhe ato.

Kështu u burrërove ti,

qyteti im!

Mbi kube të forta
u ngrit çdo shtëpi,
Heroizmi u takonte të gjithëve,
ndaj ti s'ngrite harqe për një njéri.

BASHKUDHËTARI IM

Te pragu i shtëpisë sonë
me kallamishte dhe me baltë,
qerre shumë kishin kaluar
edhe fshatarë mustaqeartë.

Te pragu i shtëpisë pushonin
e pinin ujë te pusi ynë,
duhan shkëmbenin me babanë
dhe disa fjalë për lirinë.

Vitet me uturimë kaluan,
si vargani i trenave kalon,
mbi pragun që e hëngrën vitet,
një shtresë ne hodhëm me beton.

Tani mbi pragun e shtëpisë
trenat rrëshqasin mbi dy dej,
po babai im fuk^{shk} është më,
me ta cigare të shkëmbejë.

Unë të dy duart lart i ngre
kur trenat turren që matanë,
për vete njérën dorë e ngre
dhe dorën tjetër pér babanë.

GRYKAT E KURVELESHIT

Hej
gryka tē Kurveleshit!
Tē shpuara nga isua pérjetë,
gryka tē gërryera nga gjaku,
gryka tē krisura nga rrufetë.

Këtu e pa armiku si luftohet,
këtu e pa si bëhet përshest,
nëpër këto pesë gryka
vetëm pesë cepat e yllit kaluan
thellë
në zemrën tënde, Kurvelesh.

O TRENATË MËNGJESIT!

Rrëshqisni mbi shinat me vësë
nën qienin blu me dy-tri yje,
ju presin punëtorët në stacione
me padurimin e një fëmije.

Ata ngrihen herët nga krevati
ëndrrat e mëngjesit lënë në mes,
ata nisen drejt kantiereve
që ëndërrimi kurri të mos vdesë.
Mësoj është

Ngjiten shpejt në vagona,
me bukën vënë nën sjetull,
gjaku u lëviz poshtë këmishës
dhe dielli u pikon nëpër vetull.

Në këtë orë unë ende fle
dhe ndodh shpesh që ëndërroj,
njëri i vogël do të isha
po t'i mirrja punëtorët nëpër gojë.

O trëna të mëngjesit,
mushkërizgjeruar më punëtorë,
kur jini vallë më të bnderuar,
në çorë të udhëtimieve,
në çorë?!

E DIEL DIMRI

Qielli șipér plumb,
malet poshtë gri,
ecim fagepuqur
unë edhe ti.

Horizonti tutje
fapet madhështor,
varganet e reve
na e bëjnë me dorë.

Rruga me dëborë
ende e pashkelur,
si kjo dashuri,
që porsa ka çelur.

Dielli mjaft i zbehtë
lundron në një cep,
duart ne i mbajmë
bashkë në një xhep.

Dhe një zog i vogël,
që shkon nëpër ledh,
mbi flokët e saj
një fjollë bore hedh.

Fjollën e dëborës
unë s'e prek me duar,
ngjan ajo ashtu
si e nusëruar.

AQILAKA LYRICAL

LYRICAL - LYRICAL

Qielli sipér plumb
majmalet i fsheh,
thonë që dashuria
stiniët nuk i njeh.

VIOLETA ALLMUÇA

MËNGJES AKSIONI

Ka çelur ky mëngjes si ëndërr
dhe ëndrra ime me ëndrrat e të gjithëve
për të ardhmen është shkrirë...
Krahëhapur pres buzë Jonit të kaltër mëngjesin,
dhe ai vjen i pastër,
me një kthjelltësi të ndritshme, përtërirë.

Brezaret duken sikur copa qelli kanë grisur
dhe ëndrrat
i shoh lastarë të gjelbër
si shpërthejnë
në prag të këtij agimi të bardhë,
që sapo ka nisur.

Autorja punon në SMT Tiranë.

N E S È R ...

Nesér unë nisem në një udhë të largët,
përmes stacionesh, sirenash, borish,
do të udhëtoj nesér udhës së largët
nga Jugu në Veri,
nga Jugu në Veri.

Nesér...

do ngrihem herët që me natë,
herët do hapet porta e vogël e kësaj shtëpie
kur unë të nis udhëtimin e gjatë.

Nesér më pret sërisht Veriu i largët,
i largët,
i afërt,
sa unë me portën e kësaj shtëpie,
nesér...

ROJTARI I LEMIT

Midis grurit xha Rizai fytyrëqeshur
mbushte dorën plot,
dhe tek i rridhte nëpër gishta gruri i ri,
si krua i vogël, i pastër,
gëzohej si fëmijë.

Dhe tek rrinte këmbëkryq në lëmë
diçka e rinuar,
si yjet rinojnë natën,
i zgjonte dhjetëra këngë.

SKËNDER DEMOLLI

SHUMË ZHURME PËR TË COPETUAR PA ZHURME

Në pishën e lartë hipit çakalli
e fort bërtiti,
sa ushtoi tërë mali:
— O qenie fatlume dëgjoni!
Fare pa frikë tani jetoni,
ujk dhe tigër njëzëri vendosën
kthetrat të presin, u çarmatosën.
(Do të mbajnë vetëm dhëmbë,
sa për t'u mbrojtur le bar për të ngrënë.)
Si ashjëherë disa u gëzuau
nga strofkat dolen, sheshit vrapiuan.
— Nga kush do të mbrohen? — tha një gjeldëti.
— Ne do na mbrojnë nga njëri-tjetri.

Autori punon si agronom në rrethin e Korçës.

Këndoi dhelpra me gaz e drithëruar,
që torollaku shqipen s'e kish dëgjuar:

«Kujdes, kujdes

se do t'ju gjejë mënxyrë,

sa tē jenē nē kēmbē

ujk edhe tigër, kanë po atë natyrë.»

E një kaprolle, tam-tamet kur dëgjoj

ujkun nga shkëmbi provokoi:

— Të zezës mua

sa m'u mérzit jeta,

më mirë të më mbyste ujku, me kthetra,

po ujku kthetrat i paska prerë,

medet, tē shkoj tek tigri, ta pye

— Dale, moj se kjo, eshtë zhurmë

Ndryshe nga mua tigri s'mund tē bëjë...

— Jo, — tha kaprollja, — nuk na masht

kurrë,

tani komedinë tuaj e kanë parë të tërë.

— 10 —

QENI DHE KËNDESI

— Pamje nga bota e dollarit —

Një ditë qeni i zonjës Babetë, që është kryeqytetar, kur pa të fluturojë një patëqjerite retëq i tha këndesit mei qesëndi: —
— Pika! Kur ke dy krahë përsëri fluturuar edhe
— e përsëri këtë vjet që nuk m'eb ti!
A e shikon kushërirën sa lart që është ngritur, sa dhe me krahë shqipe kurrë s'kë përsëri arritur! Këndesit që inat s'i erdhi s'zvob qendrit i kakarit qenit nga gardhi:
— Se kush ngrihet më lart këtu në perëndim, o truthatë, le të matet po të dojë me qiratë.

TIGRI DHE DEVETË

— Dëgjoni, o deve, —

tigri u tha,
për qielldhe,
për ju meraku po më ha!
Që të mos lagi,
do t'ju ndërtoj mbi shkretëtirë
një çati...

Do të kënaqi!

— Na rrofsh, o tigër,
po në shkretëtirë nuk bie shi! —
i thanë devetë.

— Do t'i sjell unë
edhe retë, —
desh që t'i bindë tigri,
që të gjëmojnë plot rrebesh,
sa të çuditet dimri.

TRADITËS SË TIRANA

— Nuk e ke keq, — qeshën devetë, — ideja është e mirë, po ne pëlqejmë lirinë në jetë. E brodhi tigri nëpër botë, traktati i sigurimit i mbet në letër, por nuk e hodhi në shportë, po i gjeti një emër tjeter.

FORCA E ZAKONIT

Miut brenda në një vrimë
një çark i kish zënë pusinë.
Me të lutur ish e kotë,
çarku qenkej kokëfortë.
Por dhe miu dorë s'heq...
Ta provoj, tha, më ryshfet!
Dhe e pyet ç'ka dëshirë,
për të ngrënë e për të pirë.
I thotë çarku, pakëz vaj
më sill, të kalosh kollaj.
— Merre, është nga më i miri! —
I dha miu vaj ulliri,
por matanë s'u hodh dot
çarku e mbërtheu fort.
— Desha, i tha, që të kalonit,
po s'më la forca e zakonit.

NE PERRALLA DHE NE JETE

Tek udhëtonte në pyll njeriu i doli përballë tariu, me të shpejtë u njiti në pemë, ku zoqtë kishin folënë.

— Kemi dëgjuar të thonë, — nisën të cicerojnë, — e tregojnë përrallë se si një njeri i gjallë, kur si ti ngushtë ish gjetur, ishte shtrirë si i vdekur dhei tariu s'e kishi trazuar, — ti nuk e paske dëgjuar?

Qeshi e u tha njeriu:

— Këtë përrallë të gjithë e dinë, por jam më i sigurt në pemë, se sa poshtë me tarinë.

NKUNGULLI DHE TJEGULLA

Një nkungull plot filetë
u ngjit në kat të parë, të dytë, të tretë
ëmë së fundi hipimbi çati,
kur pér qudit qarrik formoq
një kokë, që peshë kish me kokë.
Po si u majm mirë, një ditë pa għidher,
koka ġe velur i thotë tjegullës, ku ish mbështetur:
— Të jam mirēn johës pér jetë!...
Që lart më ngjite deri tek retë! —
Ia priti tjegulla; — C'ħuwa?!
Ma dedikon lavdiné mua?...
Pa qunji sytë poshtë nē rrënnej,
që tē shikosh tē madh kush tē ka bérë!

MERIMANGA NË HALL

Porsa ra nata
e vuri kujen merimanga:
— Në asnë qoshe rrjetën s'po ma lenë,
të tëra fijet kudo m'i prenë...
— Qetësohu, e dashur merimangë! —
Ia qau lakuriqi i natës hallë, —
Ka dhe një vend,
moj mbeç pa mend,
ku nuk e luan as tërmeti...
Që sot e tutje pëlhirën ende
në gojë indiferenti!

PASQYRA E LËNDËS

ALBERT RAKIPI

| | |
|--|----|
| — Mbrëmja e parë në fshatin e rinisë | 3 |
| Stacione jetë | 5 |
| Hartimi i parë për Qemalini | 8 |
| Letër e vëllait | 10 |
| E kam dashur | 12 |
| Si blerimi i pishave | 13 |
| Në fshatin e bukur të rinisë | 14 |
| Dasma e parë | 16 |
| Mëngjes në minierë | 17 |
| Shokët e mi | 18 |
| Një çast | 20 |
| — Një tufë manushaqe | 21 |
| Naftëtarët nisen për në punë | 22 |
| Thëllëza | 23 |
| Bilbil Matohiti | 24 |
| Në shtëpinë e re | 27 |
| — Në kufi | 28 |
| Në Koman | 29 |
| Ti s'je më... | 30 |
| Vrasja e bujkut | 31 |
| Këngët | 33 |
| — Kruja | 34 |

ABAZ KERAJ

FRANO KULLI

MIMOZA AHMETI

| | | |
|----------------------|---|----|
| MUJO BUČPAPAJ | Naimit | 36 |
| | Poezia | 38 |
| | S'i dua | 39 |
| | Gjyshja | 40 |
| | Vajzë moj | 40 |
| | Kérkova-gjeta | 43 |
| | Viti i ri në qytezë | 44 |
| | Degéz gjelbëroshe | 45 |
| PREC ZOGAJ | - Mali gézohet | 46 |
| | Që të mos zemërohet | 48 |
| | Ky mal | 49 |
| | Daullja | 50 |
| | Dashurinë tonë e ndiejnë pemët | 51 |
| | Unë i dua ata sy | 52 |
| | Pér shokët | 53 |
| | Plepat rriten | 55 |
| | Pér jetë | 57 |
| | Valltari Deli | 59 |
| QAZIM SHEHU | - Të shtunat e bukura të malësisë | 60 |
| | Kthimi | 62 |
| | Nën harkun e plepave të butë | 64 |
| | Me atë trillin prej poeti | 66 |
| | Këngë | 67 |
| RITVAN DIBRA | - Shëtitja anës hekurudhës Tingulli i hekurit dhe i gurit | 69 |
| | Rrëfim i qerritarit plak | 71 |
| | Ura e re mbi Drin | 72 |
| | - Fémijët dhe deti | 74 |
| | Valët | 75 |
| | Vajzat e ndërmarrjes artistike «Migjeni» | 77 |
| RRAPO ZGURI | Në Reç | 78 |
| | Lirikë | 80 |
| | Në Theth | 81 |
| | Këmbanat | 82 |
| | - Küjtimet e Vendlindjes | 83 |
| | Bujku | 84 |
| | Akuarel prilli | 85 |
| | Ak-Hissar | 86 |
| | Kënga himariote | 88 |
| | Qeleshja | 91 |
| | Treni i pasdites | 92 |
| | | 94 |

SAMI GJOKA

| | |
|------------------------------|----|
| — Shpirti i fshatarit | 95 |
| Në minierën e Gérdecit | 98 |
| Njeriu i lartësive | 98 |
| Mall | 99 |

| | |
|--------------------------------------|-----|
| Më rrëmbeu kujtimi i asaj nate | 100 |
| Mëngjes në Manëz | 102 |
| Vajzat e fshatit tim | 103 |
| Natë vjeshte në stan | 105 |
| Në klasë | 106 |

SIMON VRUSHO

| | |
|---------------------------------|-----|
| — Jam lidhur me ty | 107 |
| Traktori shqiptar | 108 |
| Epjosi | 109 |
| Pavdekësia jonë | 112 |
| Fara | 114 |
| Ura e Goricës | 115 |
| Xhuvel! Xhuvel | 117 |
| Pluhuri mbi bejtexhinxjtë | 118 |
| Gjyqi kundër Vrionasve | 120 |
| në Qafën e Sinjës | 120 |

SINAN KËRPAÇI

| | |
|-------------------------------|-----|
| — Zërat e fëmijërisë | 122 |
| Pianistja e vogël | 124 |
| Qenit të stanit | 126 |
| Vjelësja e portokalleve | 128 |
| Bisedat me telefon | 130 |

VASIL DILO

| | |
|---------------------------------|-----|
| Fushëbardha të bardhën | 132 |
| e kishte vetëm në emër | 132 |
| — Rruga që endet mbi çati | 134 |
| Shokët | 136 |
| Dëbora në minierë | 138 |
| Harqet e qytetit tim | 139 |
| Bashkudhëtari im | 140 |
| Gryka e Kurveleshit | 142 |
| O trena të mëngjesit | 143 |
| E diel dimri | 145 |

VIOLETA ALLMUÇA

| | |
|-------------------------|-----|
| — Mëngjes aksioni | 148 |
| Nesër | 149 |
| Rojtari i lëmit | 150 |

SKËNDER DEMOLLI

| | |
|--|-----|
| — Shumë zhurmë për të copëtuar pa zhurmë | 151 |
| Qeni dhe këndesi | 153 |
| Tigri dhe devetë | 154 |
| Forca e zakonit | 156 |
| Në përralla dhe në jetë | 157 |
| Kungulli dhe tjegulla | 158 |
| Merimanga në hall | 159 |

Poezi nga letrarë të rinj [Përgat.
për botim nga M. Xhaxhiu etj.]
T., «Naim Frashëri» 1983.

164 f.

(B.m.) dhe 891.983-1-822

(B.v.) : 891.983-1-82

P. 78

Tirazhi 1500 kopje Formati 49x78/16 Stash. 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1983